



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.245/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova - kryesuese, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi- anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Halil Gashi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Prishtinës, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 20.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa ZL.Anr.245/2025, datë 17.10.2025, e parashtruar nga kandidati për anëtar të Kuvendit komunal në Komunën e Prishtinës, Halil Gashi, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për vendvotimet nr. 1938/01 dhe 1938/02, në shkollën Avni Rustemi, fshati Mramor, Komuna e Prishtinës, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 17.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Prishtinës, Halil Gashi, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me të cilën pretendon se ka dyshime për parregullsi në numërimin e votave në Vendvotimin 1938/01 dhe 1938/02, Mramor, shkolla "Avni Rustemi", Komuna e Prishtinës.

Më tej në ankesë theksohet se dyshimet e tij për keqpërdorim/manipulim të votës janë të arsyeshme në Qendrën e votimit 1938 në Mramor, pasi që sipas parashtruesit të ankesës Subjekti Politik AAK (Nr. 174) në këtë vendvotim ka marrë gjithsej 41 vota për Asamble. Pas përfundimit të procesit të numërimit në këtë qendër (dy vendvotimet: 1938/01 dhe 1938/02, rezulton se Halil Gashi (Nr. 50), ka marrë vetëm 3 vota individuale. Sipas informative dhe dëshmive nga Komisioneri/Vëzhguesi z. Xhylazim Gashi e cili ka qenë prezent në vendvotimin 1938/02 Shkolla Fillore "Avni Rustemi" Mramor, i njëjti ka konfirmuar se, gjatë shfletimit të fletëvotimeve, ka hasur dhe numëruar mbi 13 vota të shënuara tek Nr. 50) në të dyja klasat (1938/01 dhe 1938/02), vota këto që ishin të qarta dhe të vlefshme për kandidatin individual.

Duke pasur parasysh diskrepancën e madhe mes dëshmisë së komisionerit/vëzhguesit dhe rezultatit zyrtar shpallur (vetëm 3 vota), dhe për hir të transparencës së procesit dhe besimit të qytetarëve në integritetin zgjedhor. Kërkon nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa që të marrë vendim për hapjen dhe rinumërimin e kutive të votimit për Asamble Komunale në Vendvotimet: 1938/01 dhe 1938/02 në Mramor, Komuna e Prishtinës.

Në përgjigjen në ankesë të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve – KQZ, sqaron se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr. 16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV. Pala ankuese, nuk e ka precizuar mjaftueshëm gjendjen faktike, nuk ka dhënë prova të mjaftueshme në lidhje me pretendimet e tij, duke përfshirë këtu: Formularët e Rezultateve të Subjekteve Politike, libri i votimit, deklaratat e KVV etj

KQZ po ashtu thekson se pas pranimit të kërkesës nga PZAP, më datën 17.10.2025, ka kontaktuar me Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) të Komunës së Prishtinës nga i cili ka marrë përgjigjen si: KKZ, thekson se QV 1938 ka dy vendvotime, 1938/01 dhe 1938/02, vendvotimi 1938/01 për kryetar komune rezulton: 249 fletëvotime të vlefshme, 5 të pavlefshëm subjekti AAK rezulton 5 vota. Ndërsa për asamble në vendvotimin e njëjtë rezulton si në vijim: 254 nënshkrime, 235 të vlefshme, 19 të pavlefshëm, 18 vota bartësi i listës nga subjekti AAK dhe 2 vota për ankuesin Halil Gashi. sqaron se në vendvotimin 1938/02 Kutia për kryetar komune: 243 nënshkrime, 241 të vlefshme dhe 2 të pavlefshme subjekti AAK 3 vota 243 nënshkrime, 229- të vlefshme, 14 të pavlefshme, subjekti AAK 23 vota, ankuesi Halil Gashi në këtë vendvotim ka 1 (një) votë.

Në fund KKZ sqaroi se ka përputhje të të dhënave nga ato të krijuara në vendvotim dhe atyre të krijuara dhe verifikuar në QKN. (shih të bashkangjitur sqarimet/përgjigjet e KKZ në Prishtinë lidhur me rastin konkret, KQZ, në përgjigje i ka bashkangjitur: 1. Formularin e rezultateve për kandidatët për vendvotimet 1938/01 dhe 1938/02 komuna e Prishtinës. 2. Formulari i Rezultateve për zgjedhjet për Kryetar komune dhe 3. Formulari i Rezultateve të subjekteve politike për Kuvend Komunal. Palët ka bërë ankesë ndaj rezultateve mirëpo këto rezultate ende nuk janë publikuar, andaj në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës konstaton se:

- Ankesa është e pa bazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoj se pretendimet në ankesën e Halil Gashi, kandidat për kuvend komunal në Komunën e Prishtinës, nga Subjekti Politik AAK, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë se “ *dyshimet e tij për keqpërdorim/manipulim të votës, në Qendrën e votimit 1938 në Mramor, përkatësisht vendvotimet 1938/01 dhe 1938/02* ” paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e tij, kjo pasi që paraqitësi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë dhe nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e tij se i mungojnë votat, ndërsa pretendime e theksuara më shumë janë supozime se sa thënie të dokumentuara në fakte dhe në prova konkrete. Paneli po ashtu edhe nga përgjigja e ofruar nga KQZ-ja shihet se nuk ka pasur asnjë nga parregullsitë për të cilat pretendohen me ankesë.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 par.3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin ne përcaktohet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.


Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.245/2025, datë 20.10.2025

Kryesues i Panelit

Violeta Husaj Rugova



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.